



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 3544 / Prot. 14

Tiranë, më 10/1 /2013

Lënda: Rekomandim për “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*”.

REKOMANDIM

Nr. 02 datë 10/01 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*”.

KONSTATOVA

Më datë 21/09//2012 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontrollin administrativ pranë kontrolluesit “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*” me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për subjektet e të dhënave.
- Siguria e të dhënave personale, kofidencialiteti, masat e marra nga kontrolluesi Dhoma Kombëtare e Avokatisë, për sigurinë e të dhënave personale (neni 27,28).
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).

Kontrolli administrativ u krye në selinë e kontrolluesit “*Dhomës Kombëtare e Avokatisë*” në prani të përfaqësuesit të kontrolluesit z. Edmond Konini.

Kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*” si person juridik, është e organizuar dhe funksionon në përputhje me, Kushtetutën, ligjin “Për Profesionin e Avokatit ne Republikën e Shqipërisë” nr. 9109 date 17. 07. 2003, statutit, dhe akteve të nxjerra.

Në funksion të qëllimit dhe veprimtarisë që ushtron, kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave personale “avokat dhe “as/avokatë”.

Kontrolli administrativ u fokusua në kategorinë e të dhënave personale që kontrolluesi mbledh për subjektet e tij, ligjshmëria e këtyre të dhënave parë në aspekt me nenet 5,6 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, mënyrat e përpunimit të të dhënave, manualisht apo elektronikisht, rregullat për sigurinë kofidencialitetin të marra ose jo nga kontrolluesi etj.

Rezultoi nga kontrolli administrativ se kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*” mbledh të dhëna personale për kategorinë e subjekteve “avokat dhe “as/avokatë” në rrugë manuale dhe elektronike. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale në rrugë manuale bëhet nëpërmjet dosjeve në hardcopy që kontrolluesi krijon për subjektet e të dhënave.

Dosja manuale e subjektit të të dhënave “avokat” mbart dokumentacion të depozituar prej vetë subjektit që lidhet me; *diplomën, certifikatën e notave, vërtetim për kryerjen e stazhit dëshmi penaliteti, karta e identitetit, fotografi etj.* Në rrugë elektronike mbahen regjistrat e avokatëve aktivë, jo aktivë dhe regjistri i asistent avokatëve.

Kontrolluesi është në përgatitje e sipër të një sistemi elektronik i cili do të bëjë të mundur publikimin on-line të “regjistrat të avokatëve” sipas Dhomave të Avokatisë ku ata bëjnë pjesë. Të dhënat personale të subjekteve të të dhënave “avokat” janë hedhur në këtë sistem duke marrë pëlqimin e tyre, nëpërmjet plotësimit të nje formulari kërkesë.

U konstatua se Dhoma Kombëtare e Avokatisë disponon një sistem i cili shërben si bazë të dhënash për regjistrimin e avokatëve dhe as/avokatëve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Sistemi do të shërbejë për regjistrimin dhe identifikimin e avokatëve dhe as/avokatëve, përkatësinë se cilës dhomë zonale avokatie i përket, numri i certifikatës së avokatisë dhe data e lëshimit të saj, adresa, kontakte, arsimimi, historiku profesional, kualifikime, tituj etj.

U konstatua se kompjuterat, të cilët punonjësit e autorizuar i përdorin për të hedhur të dhënat në sistem nuk kanë hyrje të kufizuar nëpërmjet “*emrit të përdoruesit*” dhe “*fjalëkalimit*” përkatës.

U konstatua gjithashtu se aksesit në sistemin e “*Regjistrat Kombëtar*” realizohet nëpërmjet një “*emër përdoruesi*” dhe “*fjalëkalimi*” të njëjtë për të gjithë punonjësit të cilët kanë akses.

Mospërcaktimi i niveleve të aksesit në kompjutera dhe sistemin e “*Regjistrat Kombëtar*” përbën shkelje të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.

Aktualisht, në faqen zyrtare të këtij kontrolluesi (<http://www.dhka.org.al/>), u konstatua se është publikuar regjistri Kombëtar i avokatisë. Ky regjistrë kategorizon dhomat e avokatisë në bazë të ndarjeve administrative të përcaktuara, emër, mbiemër, numrin e liçensës së avokatit si dhe mundësinë e vendosjes së numrit të telefonit për ç’do avokat (aktualisht numri i telefonit nuk është vendosur). Të dhënat personale të subjekteve të të dhënave “avokat” janë hedhur në këtë sistem duke marrë pëlqimin e tyre të shprehur në formular kërkesë.

Nga kontrolli administrativ rezulton se kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare të Avokatisë*” **nuk ka rregulla të shkruara**, të përcaktuara qartë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike për subjektet e të dhënave personale “avokatë”, “as/avokatë” si kundër parashikohet në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për*

Mbrojtjen e të Dhënave Personale” gjë e cila u konsiderua si shkelje në procesverbalin e mbajtur nga grupi i kontrollit administrativ.

Konstatohet se kontrolluesi është në proces të hartimit të rregullores së brendshme “për organizimin dhe funksionimin e tij”.

Gjithashtu gjatë kontrollit **rezultoi se kontrolluesi “Dhoma Kombëtare të Avokatisë”** nuk ka bërë njoftimin pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përshkrimi i shkeljeve administrative mbështetja në prova

Gjatë kontrollit administrativ të ushtruar grupi konstatoi si shkelje;

- Kontrolluesi, “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*”, nuk ka rregulla të shkruara dhe të përcaktuara qartë për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike për subjektet e të dhënave personale “avokatë”, “as/avokatë” si kundër parashikohet në ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”.
- Kontrolluesi, “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*”, nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Konstatimet e sipërme përbëjnë shkelje administrative të:

Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (neni 27)

Masat për sigurinë e të dhënave personale

Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi

Neni 21

Përgjegjësia për të njoftuar

Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.

Gjatë kontrollit të ushtruar lidhur me disa nga shkeljet e konstatuara Kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*”, u urdhërua për të plotësuar në vijim të këtij kontrolli administrativ, detyrimin për njoftim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe marrjen e masave teknike (*emër përdoruesi dhe fjale kalim të personalizuar për çdo punonjës*), për aksesin e punonjësve në Regjistrin Kombëtar si dhe në kompjuterët në të cilët aksesohet ky regjistër.

Konstatohet se kontrolluesi “*Dhoma Kombëtare e Avokatisë*” ka realizuar detyrat e lëna dhe ka respektuar afatet të cilat ju caktuan në procesverbalin e Inspektimit Administrativ nga Grupi i Inspektimit.

REKOMANDOJ

- 1) Në zbatim të nenit 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi të marrë masa brenda 45 ditëve, për hartimin e rregullave ose përfshirjen në rregulloren e përgjithshme të Dhomës Kombëtare të Avokatisë që është duke u hartuar, të klauzolave dhe dispozitave që rregullojnë mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe kofidencialitetin e të dhënave personale sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në këtë ligj.
- 2) Kontrolluesi “Dhoma Kombëtare e Avokatisë”, mbas përmbushjes së këtyre rekomandimeve mbart detyrimin për të njoftuar Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 3) Me kalimin e këtij afati në rast mospërmbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit...*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.*

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

